



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI**

Nr. 1245 / Prot.

Pogradec, më 15 03 .2022

Lënda: Dërgim materiali për shqyrtim e miratim.

**Z.SOTIRAQ MANGËRI
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

I nderuar Z.Kryetar,

Bashkëngjitur po iu dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin, për:

" PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTRIMIT TË EKONOMISË PYJORE BISHNICË (PJESA EKONOMIKE BISHNICË, PJESA EKONOMIKE) TALLË DHE EKONOMIA KULLOSORE GURI I TOP-GJEMTH, NJËSIA ADMINISTRATIVE VELÇAN BASHKIAPOGRADEC".

Me respekt,

KRYETARI

Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1

Nr. i faqeve të relacionit shpjegues: 8

Nr. i fletëve të dokumentave që shoqërojnë projekt-vendimin: 668



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. ____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ 2022

PROJEKT VENDIM

Nr. ____, DATË ____ . ____ .2022

**“PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTRIMIT TË EKONOMISË
PYJORE BISHNICË (PJESA EKONOMIKE BISHNICË, PJESA
EKONOMIKE TALLË) DHE EKONOMIA KULLOSORE GURI I TOP-
GJEMTH, NJËSIA ADMINISTRATIVE VELÇAN BASHKIA
POGRADEC”.**

Të nderuar këshilltarë !

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të Ligjit Nr.57/2020, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, neni 11, pika 2, gërma b, sipas citimit “.. për të gjitha format e pronësisë planet e mbarështimit miratohen nga Ministri. Përjashtimisht për bashkitë, miratimi i planit të mbarështimit shoqërohet me miratimin paraprak të këshillit bashkiak përkatës..”, të Udhëzimit Nr.01, datë 26.01.2017 “Për mbajtjen e Kadastrës së Fondit Pyjor dhe Kullësor Kombëtarë”, të kontratës Nr.192/9, datë 15.04.2021 “Kontratë Shërbimi”, lidhur ndërmjet Bashkisë Pogradec dhe subjektit “**Joklen & CO Shpk**” sh.p.k, Pogradec-Albania, me Nipt **K84322601F** me adresë: “Rruga Rinia, lagjia nr.2, pallat, kat 1, zona kadastrale nr.8581, numur pasurie 4/4, pogradec”, përfaqësuar nga administratori Maliq Misliu, objekt: “Hartim Plani Mbarështimi i dhe menaxhimi ekonomia pyjore Bishnicë, pjesa ekonomike tallë dhe ekonomia kullësore Guri i top-gjemth” Bashkia Pogradec, dhe Kontratës Nr.629/4 datë 28.07.2020 “Kontratë shërbimi”, lidhur ndërmjet Bashkisë Pogradec dhe subjektit “**Joklen & CO Shpk**” sh.p.k, Pogradec-Albania, me objekt “Hartim plani Mbarështim dhe Menaxhimi Pyjore Bishnicë (Pjesa Ekonomike Bishnicë)”. Bashkia Pogradec me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe Drejtorit të Ndërmarrjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike pasi u shqyrtua relacioni i përgatitur nga Administrata e Bashkisë ku është argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, i kërkohet Këshillit Bashkiak të Bashkisë Pogradec që në mbledhjen e datës ____ . ____ .2022 të miratojë:

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin e mbarështimit të ekonomisë pyjore “Bishnicë (pjesa ekonomike Bishnicë, pjesa ekonomike Tallë), dhe ekonomia Kullosore Guri i Top – Gjemth” të hartuar nga Subjekti Joklen & CO Shpk me NIPT **K84322601F**.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Pogradec, Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Ifrastrukturave dhe Punëve Publike (Sektori i Shërbimit Pyjor), Drejtori e Çështjeve Juridike.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETARI I KËSHILLIT TËBASHKISË

SOTIRAQ MËNGRI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. ____ Prot

Pogradec, më ____ 2022

RELACION
PËR PROJEKT – VENDIMIN ME OBJEKT

“PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË MBARSHTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE
EKONOMIA PYJORE BISHNICË (PJESA EKONOMIKE BISHNICË, PJESA
EKONOMIKE TALLË), DHE EKONOMIA KULLOSORE GURI I TOP-GJEMTH”.

I NDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARE !

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, po Ju dërgojmë për shqyrtim dhe marrjen e vendimit përkatës, këtë relacion, me përmbatje si më poshtë:

Baza Ligjore:

Në mbështetje të nenit 3, nenit 8, të pikes 1 nënpika 1.1, shkronja “a” të nenit 9, nenit 27 pika 5, nenit 54 shkronjat “k” të ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; neni 11 pika 2/b e ligjit Nr.57 datë 30.04.2020 “Për Pyjet; ligjin Nr.5/2016 “Për shpalljen e monatoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime në VKM nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin sipas listës së Inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në pronësi të ish Komunave/bashkive”,

Bashkia Pogradec në kuadër pjesë të funksioneve të saj, ka dhe administrimin e qëndrueshëm të fondit pyjor/kullosor kjo sipas listës të përcaktuar me ligj. Sipërfaqja pyjore që administron Bashkia Pogradec bazuar në VKM nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime në VKM nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin sipas listës së Inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në pronësi të ish Komunave/bashkive janë gjithsej **26369.88 ha**.



Gjatë marrjes në dorzim dhe vlersimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të fondit pyjor dhe kullësor që ka kaluar në pronësi të Bashkisë Pogradec është konstatuar se planet e mbarshtrimit rezultojnë që ishin hartuar në vitet 2000-2001.

Në kuadër të administrimit të disa sipërfaqeve pyjore nga ish-komunat të cilat kanë patur në pronësi një pjesë të sipërfaqeve pyjore dhe kullësore, ku janë hartuar disa plane mbarshtrimi të cilat nuk përputheshin me standartet profesionale dhe teknike të hartimit të planeve të mbarshtrimit sikurse në të njëjtën kohë edhe këto plane janë të pavlefshme për shkak të mbarimit të afatit 10 vjeçar.

Këto plane aktualisht janë të pavlefshme në reference të ligjit nr.57/2020 “Për pyjet” i cili ka përcaktuar afatin maksimal të vlefshmërisë së planeve të mbarshtrimit 10 vjeçar.

Në kuptimin e zbatimit praktik të planeve të vjetra të mbarshtrimit është vërejtur se këto plane nuk pasqyrojnë ndryshimet që kanë ndodhur në fondin pyjor dhe kullësor gjatë periudhës 20 vjeçare në raport me volumin, sipërfaqen dhe llojet pyjore etj.

Planet e vjetra të mbarshtrimit të trashëguara nga ish-Drejtoria e Shërbimit Pyjor (ish-Ministria e Mjedisit) dhe ish-komunat nuk garantojnë një zhvillim të qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullësor.

Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore të pyjeve, kullotave dhe livadheve nënkupton mirëqeverisjen dhe përdorimin e resurseve në një mënyrë dhe me një ritëm që ruan dhe siguron biodiversitetin, prodhimtarinë aftësinë ripërtëritëse, vitalitetin dhe potencialin e tyre për të përmbushur, për sot dhe të ardhmen, funksionet ekologjike, ekonomike dhe sociale në nivel lokal dhe global.


Fondi pyjor dhe kullësor sipas ekonomive pyjore si dhe kategoritë e përdorimit të tokës brenda territorit të ekonomisë pyjore Bishnicë me pjesët ekonomike (Bishnië dhe tallë).

Ekonomia Pyjore Bishnicë pjesa ekonomike Bishnicë

Të dhënat kryesore sipas planit të mbarshtrimit 2021-2031

Përdorimi i terriorit


Perdorimi i terriorit	Aktuale,siperfaqia /ha	E propozuar siperfaqia/ha
Shtetore, bashkiake		
Pyll	1072.3	1072.0
Sip.me bimesi pyjore	7.5	7.5
Bujqesi	141.5	141.5
Kullota,livadhe	22.4	22.4
Urbane	3.4	3.4
Djerr	19.4	19.4



Joproductive	16.1	16.1
Totali:	1282.6	1282.5

Në këtë pjesë ekonomike janë parashikuar masa të ndryshme silvikulturore si pyllezime me fidana në sipërfaqet djerr dhe sipërfaqet me bimesi pyjore ngastra 15b dhe 15c me Hartinë, Arnen ose Rrobull.

Kjo pjese ekonomike dominohet nga pyll i lartë kryesisht trungishte dhe një pjesë shume pakët cungishte dhe kullotë ku specie kryesore është Ahu (*Fagus Sylvatica*), e cila jepet në grafikisht dhe në tabelën e mëposhtme:



Rrallimet do të jene te tipit të pare në trungishte, do të kryhen në 129 ha dhe do të dalin 2976 m³ dru zjarri e fashina. Rrallimet e tipit të dyte do te kryhen në trungishte në nje sipërfaqe prej 311 ha dhe do të dali nje volum prej 12349 m³, lëndë të mesme, të hollë e dru zjarri. Ky rrallim do të aplikohet në përgjithësi do të zbatohen intensistete të ulët dhe të mesëm i prerjeve.

Shfrytëzimet me prerje të njëmbasnjëshme (farore do te kryhen në një sipërfaqe prej 46 ha, në ngastrën 15a dhe 20a dhe do të rezultojë një volum prej 1650 m³ material drusor. Prerje përfundimtare do të kruhen ne një sipërfaqe të vogel prej 2 ha në parclen 14c.

Mundësia vjetore eshte e llogaritur në kete pjese ekonomike sipas metoda të ndryshme një nder metodat është **Masson-Mantel** dhe ka nxjerr një sasi **1987 m³/Vit**, kjo sasi materiali drusor do të përdoret per nevojat e enteve publike, në afatin kohor 10 vjeçar do të nxirret një sasi totale prej **19877 m³**.

Masat në kullota do të aplikohen në ngastrat 12d; 12e; 14b; 16b si: pastrim gurësh, ndërtim korite me kapacitet mbajtës 25 m³ si dhe ndërtim lere me kapacitet mbajtës 270 m³, si dhe masa të ndryshme ne infrastrukturë si instalim tombinosh, rehabilitim rruge, hapje kanalesh etj.

Ekonomia Pyjore Bishnicë pjesa ekonomike Tallë

Të dhënat kryesore sipas planit të mbarshtimit 2022-2032

Përdorimi i terriorit


Perdorimi i teritorit	Aktuale,siperfaqia /ha	E propozuar siperfaqia/ha
Shtetere, bashkiake		
Pyll	1388.37	1388.37
Sip.me bimesi pyjore	56.64	56.64
Bujqesi	77.13	77.13
Kullota,livadhe	55.20	55.20
Urbane(truall)	2.50	2.50
Ujore	11.20	11.20
Shkembore	3.21	3.21
Djerr	8.1	8.10
Joproductive	28.72	28.72
Totali:	1631.60	1631.60

Kategoria perdorimit te terriorit





Ekonomia Pyjore Bishnicë (Pjesa Ekonomikë Tallë)	Sipërfaqja në ha
Trungishte	1139.6
Trungishte e parregullt	26.8
Cungishte	222.6
Kullotë	55.2
Shuma Totale	1444.2



Pjesa ekonomike dominohet nga pyll i lartë kryesisht trungishte specie kryesore është Ahu (*Fagus Sylvatica*), dhe cungishte nga lloje pyjore të Bungës, Qarrit e cila jepet në grafikisht dhe në tabelën e mësipërme, si dhe kullota brenda pyllit, ku janë parashikuar masat e planifikuara të ndërhyrjeve.

Ne kete pjese ekonomike jane parashikuar masa te ndryshme silvikulturore si pyllezime me fidana ne siperfaqet djerr dhe siperfaqet me bimesi pyjore ngastra me nje siperfaqe pre 13.35 ha me llojin hartine, arnen ose rrobull, pise e zeze. Pyllezime me fare jane parashikuar ne ngastre 18a,18b ,24a,24b ku pylli eshte prere nga prerjet pa leje dhe ka nje kuroredendesi 04-05 me llojin bredh dhe ah.

Rralime te tipit te pare në trungishte 425.8 ha dhe volum prej 39953.0 m³, rrallim e tipit te dyte, do te kryhen në trungishte 148.5 ha dhe do te nxirret nje volum prej 14330.0 m³, lende e holle, te mesme, dhe dru zjarri.

Shfrytezimet me prerje te njembasnjeshme (farore do te kryhen) ne nje siperfaqe prej 87.5 ha, me nje volum prej 5885.0 m³, ne Prerje sanitare do te kryhen ne nje siperfaqe prej 146 ha dhe nje volum prej 14691m³, do të aplikohen në pyje të lartë dhe në pyjet e mesëm.

Masat në kullota të cilat ndodhen mbrenda pyllit janë planifikuar masa të ndryshme kryesisht në ngastrat 24b; pastrim gurësh me një sipërfaqe 4.5 ha; 21k do të kryhet një sipërfaqe prej 1.9 ha,



Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,

PËRGATITI MATERIALIN:

Konceptoi:

PËRGJEGJËS SEKTORI

Ing. ARBEN BRAHO

Pranoi/Miratoi:

DREJTORI N.M.I.P.P

ENTON BERBERI

Konfirmoi:

KRYETAR

ILIR XHAKOLLI

